



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

V E N D I M

Nr. 2508, datë 30.10.2014

Për

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Antëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 30.10.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (K.Pr.A);
3. Rregulloren nr. 18, datë 11.6.2010 “Për procedurat e zgjidhje së mosmarrëveshjeve”;
4. Rregullore nr. 19, datë 14.6.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresë e Nisatel sh.p.k, me nr. 215/1Prot., datë 25.8.2014 (*nr. 2018Prot. i AKEP, datë 1.9.2014*) “*Kërkesë për fillimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.*”.
- Shkresë e Nisatel sh.p.k, nr. 215/2Prot, datë 15.9.2014, me anë të së cilës ka depozituar korrespondencat në formë elektronike me Albtelecom sh.a. në përgjigje të shkresës së AKEP nr. 2018/1Prot, datë 8.9.2014 drejtuar Nisatel për plotësim dokumentacioni;
- Korrespondencën në formë elektronike të shkëmbyer mes palëve.
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**),

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

Nisatel sh.p.k., më datat 8 Maj 2014 dhe 26 Qershor 2014, ka marrë nga Albtelecom kërkesën për nënshkrimin e draftit të ri të RIO-s që Albtelecom sh.a. ka përgatitur për nënshkrim mes tij dhe operatorëve të tjerë.

Nisatel sh.p.k. shpjegon se, ka plotësuar dhe dërguar në formë elektronike dhe përmes rrugës postare të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Albtelecom sh.a. për nënshkrimin e marrëveshjes së re të interkoneksionit.

Nisatel sh.p.k. deklaron se gjatë negociimit të draft-marrëveshjes së re të interkoneksionit bazuar në (RIO) janë konstatuar mosmarrveshje të dukshme dhe në dem te operatorëve me të cilet Albtelecom sh.a. kërkon dhe është i detyruar të lidhë marrëveshje interkoneksioni.

Nisatel sh.p.k. shpjegon se ka zhvilluar disa takime me Albtelecom sh.a. në të cilat ka shprehur komentet e veta në lidhje me draftin e propozuar dhe po ashtu kerkoj që të përmiresohen pika të caktuara në interes të dyanshëm.

I. Në lidhje me këtë mosmarrëveshje Nisatel sh.p.k. shprehet se:

1. Albtelecom sh.a., aplikon tarifën e tranzitit të thirrjeve nga rrjeti fiks Albetelcom në rrjetin Albetelcom Mobile që paraqet ‘non-sens’ duke pasur parasysh se Albtelecom sh.a. është një subjekt i vetem, me një NIPT të vetëm dhe nuk mund të bëjë abuzime duke përdorur dy kritere të ndryshme brenda të njejtit subjekt dhe për njësi integrale të tija. Kërkohet që aplikimi i tarifës së tranzitimit drejt Eagle Mobile që bëhet nga Albtelecom të largohet nga MI përkatësisht të mos tarifohet ashtu sikurse veprohet dhe me operatorët AMC dhe Vodafone Al.
2. Albtelecom sh.a. nuk lejon tranzitin e trafikut nga qendra tranzitore e Nisatel drejt OASH-ve për trafikun ndërkombetar të mbledhur nga Nisatel dhe dedikuar

- OASH-ve. Ofrimi i shërbimeve tranzitore është i drejtë dhe përcatuar me ligj dhe po ashtu përzgjedhja e operatoreve të cilët kërkojnë që trafiku i tyre i mbledhur nga Nisatel të tranzitohet përmes rrjetit të Albtelecom është e drejtë e pacënueshme. RIO e miratuar nga AKEP ka përcaktuar qartë detyrimin e ofrimit të trazitimit pa e dalluar dhe ndare atë në trazitim kombëtar dhe ndërkombëtar. Kërkohej që të ndërpritet një abuzivitet i tillë nga Albtelecom sh.a. dhe mospengim i punës së operatorëve që operojnë në të njëjtën fushë duke ua mohuar atyre të drejtën e përzgjedhjes së operatorit nga i cili do të marrin trafikun e vet ndërkombëtar.
3. Albtelecom sh.a. aplikon dhe ka më shumë se sa një vit që faturon pa të drejtë Nisatel për numrat e portuar në vlerën 600 Lek/numër. Edhe pse nuk ka marrëveshje dhe çmim të përcaktuar apo negociuar paraprakisht nga palët. Nisatel Sh.p.k. ka kërkuar negociimin e tarifës, rregullimin e saj me një pikë të veçantë në marrëveshjen e interkoneksionit dhe ka propozuar vlerën 250 Lekë. Rregullorja e portabilitetit, VKD e AKEP, përcakton shprehimisht që operatorët mund të shkëmbejnë një tarifë për portabilitetin deri në vlerën e sipërme kufi 600 Lek/numër duke e vendosur me marrëveshje midis tyre tarifën. Por Albtelecom jo vetëm që nuk e negocion por vazhdon të tarifoje mbi baza jo ligjore dhe gjeneron fatura të paligjshme në kurriz të operatorit Nisatel për këtë shërbim. Vlerën e këtyre faturave e ka mbajtur me forcë si diferencë në pagesat e interkoneksionit pa marrë pëlqimin paraprak dhe miratimin e Nisatel.
 4. Albtelecom ka përcaktuar në draftin e MI dhe kërkon që të firmoset MI me përcaktimin e tarifës së terminimit të numrave të portuar Albtelecom në rrjetin Nisatel të barabartë me tarifën e trafikut kombëtar, ndërkohë që Nisatel e ka apeluar VKD e AKEP dhe është ende në pritje të një vendimi përfundimtar për këtë çështje. Pra një çështje e cila është ende në proces gjykimi nuk mund të jete pjesë e marrëveshjes deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga AKEP.
 5. Nisatel ka kërkuar një pikë lokale interkoneksioni në qytetin Durrës, por Albtelecom e ka zvarritur implementimin dhe miratimin e kësaj kërkesë dhe nuk ka pranuar që kjo pikë interkoneksioni e kërkuar nga Nisatel të përfshihet në draftin e MI.

Për situatën e krijuar, Nisatel sh.p.k. shpjegon se, ka pasur komunikime telefonike, e-mail dhe disa takime, duke kërkuar shpjegime për këto pika që ka mosmarrëveshje duke i cilësuar ato në kundërshtim me:

- a- Marrëveshjen e Interkoneksionit , dt.24.06.2011Nr.Prot 2929 / Neni 27;
- b- Rregulloren Nr. 18 datë 11.06.2010 "Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve "
- c- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" neni 8, (gërma n), neni 22 (pika 5) neni 49 (gërma 2/b) neni 50, neni 60 dhe neni 120.
- d- Ligji Nr. 8485 datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"
- e- Rregullore Nr.13, datë 16.04.2010 per "Portabilitetin e Numrit";

- f- VKD nr. 2403 dt. 26.12.2013 "Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, të përditësuar, të sipërmarrësit Altelecom Sh.a."
- g- Rregullorja për Akses dhe Interkoneksion, miratuar me Vendimin Nr.1300 datë 14.06.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP e ndryshuar.

Për sa më sipër, Nisatel sh.p.k. kërkon që AKEP të iniciojë urgjentisht procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

II. *Në përgjigje të pretendimeve si më lart të Nisatel, Altelecom në korrespondencat në formë elektronike (të depozituara nga Nisatel në AKEP) shprehet se:*

1. Sa i takon tarifës së tranzitit të thirrjeve nga rrjeti fiks i Altelecom në rrjetin mobile të Altelecom, Altelecom po zbaton ORI-n e miratuar nga AKEP. Në zbatim sa më lart, Altelecom operon me dy RIO dhe dy marrëveshje të veçanta interkoneksioni, dhe tarifimi i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve nga rrjeti fiks në mobile tarifohet sipas përcaktimeve në këto RIO.
2. Altelecom, në zbatim të RIO-s së miratuar nga AKEP, nuk ka detyrim ligjor të ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve për trafikun ndërkombëtar të tranzituar nga Nisatel drejt operatorëve alternativë të cilët nuk kanë lidhje direkte me Nisatel. Ky i fundit, duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit për këta operatorë mbështetur në rrejtin e tij.
3. Sa i takon pikës së re të interkoneksionit, në Durrës sqaron Altelecom, Nisatel-it i është dërguar draft marrëveshja dhe pritët plotësimi i dokumentacionit sipas draftit të dërguar më datat 8 maj dhe 26 qershor 2014. Altelecom shprehet edhe për tejkalimin e afatit për nënshkrimin e marrëveshjes së re të interkoneksionit, dhe se me të gjithë operatorët alternativë i ka nënshkruar MI e reja dhe e ka përfunduar këtë proces.
4. Për tarifën e numrit të portuar, Altelecom ka sqaruar se, këtë tarifë Altelecom e zbaton në referencë me vendimin e AKEP, që prej dy vjetësh, me të gjithë operatorët dhe është e njëjtë si për shërbimin pot-in dhe port-out.

AKEP, konstaton se, njoftimi me shkrim për mosmarrëveshjen nga Nisatel sh.p.k., përmban informacionin e kërkuar të përshkruar në “*Rregulloren nr. 18, datë 11.6.2010 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve*”, dhe konsiderohet se përmbush kushtet ligjore për pranimin e kërkesës dhe shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga AKEP-i duke proceduar administrativisht, sipas procedurës së parashikuar në nenin 120 të ligjit nr. 9918 të ndryshuar,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, dhe në nenin 46 e vijues të K.Pr.A,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Nuredin Hasanaj Anëtar
 - Filiola Ristani Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**